

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6931
E hënë, 26 qershor 2023
Çmimi 0.40

Kongresisti Torres: Dialogu është kthyer në shpatë që Serbia po e përdor si armë kundër Kosovës



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

DËME TË MËDHA NGA VËRSHIMET NË QYTETIN E PEJËS

PEJA PËRMBYTET NGA VËRSHIMET, HUMBIN JETËN NËNË E BIR



Komuna e Pejës të shtunën në mbrëmje është përballur me vërshime të mëdha në disa zona të rëndësishme të qytetit. Vërshimet në këtë qytet kanë marrë jetën e dy personave, një nëne me të birin e saj pesëvjeçar. Dëmet materiale në

shtëpi, dyqane, objekte publike dhe në infrastrukturë rrugore janë të mëdha. Komuna e Pejës ka mobilizuar Shtabin Emergjent për t'i adresuar nevojat dhe sfidat. Njësitë e FSK-së të kërkim-shpëtimit kanë dalë tashme në

terren për të ndihmuar për përballimin e situatës. Familjes Ademaj, e cila humbi dy anëtarë si pasojë e vërshimeve, i kanë shprehur ngushëllime përfaqësuesit e institucioneve dhe liderët e partive opozitare

OVLUÇ-ja: PROCESI I VERIFIKIMIT TË VETERANËVE S'MUND TË BËHET SA HERË I TEKET DIKUJT



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht -Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
E-mail: renova@mt.net.mk
Fax: +389 44 487 200
Mbx: +377 44 501 289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

SPORT



NUREDIN REXHEPI, TALENTI I RADHËS QË I THOTË 'PO' KOSOVËS

F. 10

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

OVLUÇK-ja: Procesi i verifikimit të veteranëve s'mund të bëhet sa herë i teket dikujt

PRISHTINË, 25 QERSHOR - Organizata e Veteranëve e Luftës së UÇK-së po e kundërshton procesin e riverifikimit përmes ligjit të ri. Pa përfundimin e procesit gjyqësor, Xhavit Jashari thekson se askush nuk ka të drejtë të krijojë komisione të tjera. Madje, siç thotë ai, kryeministri Albin Kurti nuk duhet ta luajë rolin e prokurorit e as të gjykatësit. Jashari pohon se ka mospajtime me organizatat e dala nga lufta sa i takon ligjit të ri vetëm për veteranët, që nënkupton riverifikimin e statusit të tyre.

Një vit më parë ka kaluar në lexim të parë projektligji në parim për pagën minimale prej 264 eurosh bruto. Që nga ajo kohë ka mbetur i pamiruar në lexim të dytë për shkak të kërkesave të veteranëve për përfshirje në këtë projektligj. Në të njëjtën kohë janë organizuar edhe protesta nga veteranët pranë objektit të Kuvendit të Kosovës.

Xhavit Jashari nga Organizatat e Veteranëve të Luftës së UÇK-së ka deklaruar për "KosovaPress" se i vetmi institucion që mund ta bëjë riverifikimin janë komandantët

dhe zinxhiri komandues. "Askush nuk i frikësohet riverifikimit, por kryeministri duhet ta luajë rolin e kryeministrit dhe kur po hyn në tema të tilla me të vërtetë unë atëherë nuk po e di a është kryeministër, prokuror apo gjykatës. Ai nuk duhet të përzihet. Ne jemi në një proces gjyqësor që për shkak të verifikimit të veteranëve dhe pa përfundimin e këtij procesi nuk ka të drejtë askush të krijojë komisione të tjera dhe duhet ta dijë edhe kryeministri dhe çdokush tjetër që i vetmi institucion që mund ta bëjë verifikimin janë komandantët e zonave me zinxhirin komandues. Pra, ky verifikim është bërë nga komandantët dhe zinxhiri komandues dhe ka dalë ai numër, i cili tani edhe po kontestohet dhe jemi në një proces gjyqësor", thotë Jashari. Për më tepër, ai thekson se procesi që përfshin verifikimin e statusit të veteranëve nuk mund të bëhet "sa herë i teket" politikës. "Kjo nuk mund të bëhet sa herë t'i teket dikujt në aspekte politike që të krijohen komisione dhe të vazhdohet tutje të diskriminohen këto kategori. Mendoj se edhe nëse



krijohet, janë dy organe kompetente. Janë komandantët me zinxhirin komandues dhe në rast se ka shtim të numrit apo mohim të drejtës së dikujt që ka qenë pjesë e luftës së UÇK-së nga këto kategori, është organi përfundimtar-gjykata, e cila vendos dhe i rregullon këto çështje sipas ligjeve në fuqi", ka thënë Jashari.

Ndërsa deputetja e Partisë Demokratike të Kosovës, Ganimete Musliu, shprehet se veteranët e luftës së UÇK-së

duhet të trajtohen dinjitetshëm. "Veteranët e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës duhet të trajtohen me dinjitet. Se a janë duke u trajtuar me dinjitet? Unë them me plot bindje që jo. Vetë fakti që sot kemi veteranë, invalidë të UÇK-së, të cilët nuk kanë mundësi t'i paguajnë protezat për invaliditetin e tyre gjatë luftës, nga plagët që kanë marrë, kjo tregon për gjendjen se si po trajtohen veteranët. Është momenti i fundit që veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës të

trajtohen dinjitetshëm me ligj", shton Musliu.

Sipas saj, kryeministri Albin Kurti duhet të bisedojë me shoqatat e dala nga lufta që të ketë një zgjidhje për këtë kategori.

Shefi i ekzekutivit ka pranuar ditë më parë se ka mospajtime me Organizatën e Veteranëve të Luftës për rregullimin e statusit të tyre. Ai ka përsëritur qëndrimin përmes hartimit të një ligji të ri të nisë procesi për verifikimin e veteranëve.

Kongresisti Torres: Dialogu është kthyer në shpatë që Serbia po e përdor si armë kundër Kosovës



PRISHTINË, 25 QERSHOR - Kongresisti amerikan Ritchie Torres ka deklaruar se dialogu Kosovë - Serbi është kthyer më shumë në shpatë sesa në mburojë. Sipas tij, në vend se dialogu të veprojë si mburojë që mbron pavarësinë e Kosovës, është kthyer në shpatë që po përdoret nga Serbia si armë kundër Kosovës. Torres në intervistën në

"InsideAlbania" ka deklaruar se në një kohë kur ndikimi i Shteteve të Bashkuara është në rënie, ajo nuk duhet t'i marrë si të mirëqenë aleatët e saj, përfshirë Kosovën. Torres, një anëtar i Partisë Demokratike, ka qenë një nga zërat e paktit të ShBA-së që ka qëndruar në mbështetje të Kosovës në mes të thirrjeve në rritje që Kosova ta

depërkallëzohet situatën në veri nën kërcënimin e sanksioneve të ShBA-së dhe BE-së. "Ne po jetojmë në një kohë ku ndikimi i Shteteve të Bashkuara mund të jetë në rënie dhe ne nuk mund t'i marrim aleatët tanë si të mirëqenë. Ne duhet të jemi proaktivë në ruajtjen e aleancave tona", është shprehur kongresmeni amerikan. Ai ka theksuar se Vladimir Putini

është figura më popullore në Serbi dhe se një politikë e pajtimit me Serbinë nuk ka gjasa ta rrisë ndikimin e ShBA-së apo BE-së brenda Serbisë. "Kur shkoj në Kosovë ka një ndjenjë të thellë mirëkuptimi dhe besnikërie ndaj Shteteve të Bashkuara. Me shaka kam thënë se në Kosovë ka më shumë dashuri për Shtetet e Bashkuara sesa në Shtetet e Bashkuara. Pse

do ta hidhnim poshtë këtë mirëkuptim?", ka shtuar Torres. Ai ka theksuar se prioriteti më i lartë duhet të jetë siguria dhe integriteti i Kosovës si shtet i njohjes së Kosovës si shtet i pavarur dhe integriteti i Kosovës së pari në Bashkimin Evropian dhe NATO-ja, e në fund të fundit në bashkësinë ndërkombëtare. "Kjo duhet të mbetet politika e Evropës dhe e Shteteve të Bashkuara", ka përfunduar ai.



DËME TË MËDHA NGA VËRSHIMET NË QYTETIN E PEJËS

Peja përmbytet nga vërshimet, humbin jetën nënë e bir

Komuna e Pejës të shtunën në mbrëmje është përballur me vërshime të mëdha në disa zona të rëndësishme të qytetit. Vërshimet në këtë qytet kanë marrë jetën e dy personave, një nënë me të birin e saj pesëvjeçar. Dëmet materiale në shtëpi, dyqane, objekte publike dhe në infrastrukturë rrugore janë të mëdha. Komuna e Pejës ka mobilizuar Shtabin Emergjent për t'i adresuar nevojat dhe sfidat që dalin nga ky fenomen natyror. Njësitet e FSK-së të kërkim-shpëtimit kanë dalë tashmë në terren për të ndihmuar në përballimin e situatës. Familjes Ademaj, e cila humbi dy anëtarë të saj si pasojë e vërshimeve, u kanë shprehur ngushëllime përfaqësuesit e institucioneve dhe liderët e partive opozitare

EPOKA E RE**Mal QORRAJ**

Pejë, 25 qershor - Të shtunën komuna e Pejës është përballur me vërshime të mëdha në disa zona të rëndësishme të qytetit. Si pasojë e vërshimeve, një nënë bashkë me fëmijën e saj 5 vjeç kanë vdekur. Sipas policisë, nëna fillimisht është zhdukur, por është gjetur pas kërkimeve të ekipeve policore në lagjen "Asllan Qeshme". Përveç tyre, në lagjen "Fidanishte", po në Pejë, dy persona kanë pësuar lëndime trupore dhe janë dërguar në spital. Pothuajse i gjithë qyteti është mbuluar nga vërshimet dhe dëmet materiale si në shtëpi, dyqane, objekte publike

dhe në infrastrukturë rrugore janë të mëdha.

Ministri i Mbrojtjes në Kosovë, Armend Mehaj, menjëherë ka nisur njësitet e Forcës së Sigurisë së Kosovës për kërkim-shpëtim për t'u ndihmuar banorëve që janë goditur nga vërshimet.

Kryetari i komunës së Pejës, Gazmend Muhaxheri, i ka shprehur ngushëllime familjes Ademaj për humbjen e dy anëtarëve të familjes. "Jam shumë i tronditur për rastin tragjik që ka ndodhur sonte në Pejë si pasojë e vërshimeve, ku ka pasur edhe humbje jete të çmuara! Kjo është një situatë e rëndë dhe e hidhur për qytetin tonë", ka thënë Muhaxheri.

Ai ka theksuar se në ditët e

fundit komuna që drejton është përballur me reshje të shiut dhe shfaqje të vërshimeve në disa zona të rëndësishme të qytetit. Ai ka thënë se Shtabi Emergjent është mobilizuar menjëherë pas vërejtjes së situatës dhe ekipet janë duke punuar pa pushim për t'i adresuar nevojat dhe sfidat që dalin nga ky fenomen natyror. "Gjatë kësaj kohe të vështirë, shpreh ngushëllimet dhe solidaritetin tim të plotë. Shpresoj të kenë forcë për ta kaluar këtë situatë. Ndihma në kohë të vështira është thelbësore. Ekipet tona janë në terren dhe po e vëzhgojnë situatën e shkaktuar nga vërshimet", ka thënë kryetari i Pejës.

Kurti: Qeveria do të ofrojë mbështetje

Kryeministri Albin Kurti ka thënë se me pikëllim të thellë ka marrë lajmin për humbjen tragjike të jetëve të dy qytetarëve, Dion Ademaj dhe Mirsada Ademaj, nga vërshimet. "Kjo humbje e madhe për familjet Ademaj dhe Hoxhiq është humbje e madhe për vendin tonë. Në këto ditë të rënda dhembjen e ndajmë bashkë me familjarët dhe miqtë e tyre. Në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe në emrin tim personal, ju shpreh ngushëllimet më të sinqerta. Të lënduarve u uroj shërim sa më të shpejtë", ka thënë Kurti. Ai ka theksuar se Qeveria e Republikës së Kosovës është e angazhuar me kapacitetet e saj me Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Agjencinë për Menaxhimin e Emergjencave që të ndihmojë në përballimin dhe tejkalimin e pasojave nga vërshimet. "Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla dhe ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal, Elbert

Krasniqi, janë në komunikim me komunën e Pejës për t'i koordinuar veprimet për ofrim të mbështetjes së nevojshme", ka deklaruar kryeministri Kurti. Presidentja Vjosa Osmani ka theksuar se humbja e dy qytetarëve tanë si pasojë e vërshimeve në Pejë ka tronditur gjithë Kosovën. "U shpreh ngushëllimet më të thella familjarëve, miqve, kryetarit të komunës, z. Gazmend Muhaxheri dhe gjithë qytetarëve të komunës së Pejës për këtë humbje të madhe e kaq tragjike", ka deklaruar Osmani.

Kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca, i ka shprehur ngushëllime familjes Ademaj për humbjen e dy familjarëve. Ai ka theksuar kjo fatkeqësi na prek secilin dhe ka tronditur të gjithë qytetarët e Kosovës. "Në këto momente qëndrojmë pranë familjarëve të viktimave, siç jemi pranë të gjithë qytetarëve të Pejës, të cilët kanë pësuar nga këto vërshime. Njësitet përkatëse të emergjencave me profesionalizmin e tyre janë duke ofruar ndihmën dhe punën e tyre deri në stabilizim të plotë të situatës", ka theksuar Konjufca.

Haradinaj viziton qytetin e Pejës

Kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka vizituar qytetin e Pejës, për të parë nga afër situatën e krijuar pas vërshimeve. “Ndamë dhimbjen me familjen Ademaj, e cila humbi më të dashurit e tyre në këtë tragjedi. Ftoj Qeverinë e Kosovës dhe institucionet relevante për mobilizim të menjëhershëm duke ndarë një fond emergjent për t’u dalë në ndihmë të gjitha familjeve të cilat pësuan nga këto vërshime. Jemi me qytetarët e Pejës në këto ditë të vështira!” ka thënë Haradinaj.

Krasniqi: Qeveria t’i ndihmojë qytetarët e Pejës për përballimin e kësaj fatkeqësie

“Thellësisht i pikëlluar me ngjarjen tragjike në Pejë, ku si

Ai e ka ftuar Qeverinë e Kosovës të jetë aktive dhe t’i shfrytëzojë të gjitha kapacitetet e saj logjistike e materiale për ndihmë qytetarëve dhe institucioneve të Pejës për përballimin e kësaj fatkeqësie.

Abdixhiku: Institucionet tona t’u përgjigjen nevojave të familjeve në përballje me këtë situatë

Edhe kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku, ka reaguar pas humbjes së jetës së nënës dhe fëmijës së saj 5-vjeçar si pasojë e reshjeve të shiut në komunën e Pejës. “Jam në komunikim të vazhdueshëm me kryetarin e komunës së Pejës, Gazmend Muhaxheri, pas vërshimeve të shiut të cilat shkaktuan humbje jetësh e dëme të mëdha në disa lagje të Pejës. Ngjarja tragjike e vdekjes së nënës dhe fëmijës së saj është humbje e madhe për familjen, për qytetin e Pejës si



pasojë e vërshimeve kanë humbur jetën Mirsada dhe Dion Ademaj, nënë e bir, 30 respektivisht 5 vjeç. Në momente të rënda si ky, me zemër dhe mendje jam pranë familjes Ademaj për ta ndarë dhembjen e madhe nga humbja e më të dashurve të tyre. Në emrin tim dhe të Partisë Demokratike të Kosovës, ngushëllimet më të thella familjes, miqve dhe të gjithë qytetit të Pejës, të cilët u goditën nga kjo fatkeqësi natyrore”, ka thënë lideri i PDK-së, Memli Krasniqi.

dhe për të gjithë ne. Prandaj në emrin tim dhe të Lidhjes Demokratike të Kosovës u shpreh ngushëllime familjes Ademaj, ndërsa të lënduarve të tjerë shërim të shpejtë e të plotë. Në kohë të vështira si kjo nga fatkeqësitë natyrore, të cilat janë të paparishkueshme, duhet të jemi solidarë dhe ta përkrahim njëri-tjetrin”, ka thënë lideri i LDK-së. Abdixhiku u ka bërë thirrje institucioneve qendrore t’i mobilizojnë të gjithë mekanizmat shtetërorë dhe t’u dalin në ndihmë qytetarëve të prekur nga vërshimet.

Pacolli hap “Go Fund Me” për ta ndihmuar familjen Ademaj

Kryetari i Aleancës Kosova e Re, Behgjet Pacolli, ka hapur një “Go Fund Me” për ta ndihmuar familjen Ademaj nga Peja. Përmes llogarisë zyrtare në “Facebook”, ai u ka bërë thirrje

politikanëve, biznesmenëve dhe të gjithëve për të kontribuar. “Sapo kam hapur një ‘GoFundMe’ për të ndihmuar së bashku financiarisht familjen Ademaj. U bëj thirrje

politikanëve, biznesmenëve dhe të gjithëve me zemër dhe mundësi për të kontribuar. Çdo euro do të thotë shumë për familjen. Zoti ju shpërbleftë!”, ka shkruar Pacolli.

“Institucionet tona duhet të koordinohen me të gjitha

organet lokale për t’iu përgjigjur nevojave të familjeve

tona në përballje me këtë situatë”, ka thënë Abdixhiku.



Akademiku Qosja mbush 87 vjet, presidenti i Shqipërisë: Pasuri kombëtare e mendimit

Prishtinë, 25 qershor - Akademiku Rexhep Qosja sot mbushi 87 vjet. Me këtë rast, krerët e shtetit shqiptar e uruan Qosjen për ditëlindje si dhe e vlerësuan lart figurën e tij.


Presidenti i Shqipërisë, Bajram Begaj, për Qosjen u shpreh se është pasuri kombëtare. "Shumë urime për ditëlindje Akademikut Rexhep Qosja! Profesor Qosja është një pasuri kombëtare e

mendimit të cilin e ka shprehur me shqipen plot elegancë në krijimtarinë e tij shkencore, historike, letrare, artistike dhe publicistike. Jetë të gjatë e të lumtur Profesor!", ka shkruar Begaj në "Facebook".

Me rastin e 87-vjetorit të lindjes, Qosjen e uroi edhe kryetarja e Kuvendit të Shqipërisë, Lindita Nikolla. Ajo i uroi shëndet e jetë të gjatë. "Sot, në ditën e lindjes, i

uroj akademikut të shquar, Rexhep Qosja, shëndet, jetë të gjatë e të lumtur dhe vijimin e krijimtarisë së Tij të begatë, në shërbim të shqiptarëve!", ka shkruar Nikolla në "Facebook".

Rexhep Qosja ka lindur më 25 qershor të vitit 1936 në Vuthaj të Malit të Zi. Ai është historian letërsie, kritik letrar, shkrimtar, publicist, politikan dhe akademik. Ai është autor i disa romaneve të njohura.



Policia kap sasi të armatimeve në Zveçan, Sveçla: Qëllimi ishte realizimi i sulmeve terroriste

ZVEÇAN, 25 QERSHOR - Ministri i Punëve të Brendshme i Kosovës, Xhelal Sveçla, ka njoftuar se njësitë e specializuara të Policisë së Kosovës kanë gjetur një sasi të madhe të armatimeve në Zveçan. Sveçla ka theksuar se ato janë gjetur në "një veturë me targa të Beogradit" dhe "rreth 100 metra larg komunës së Zveçanit".

Ai ka theksuar se në veturë janë zbuluar sasi të mëdha të armatimeve, mjeteve shpërthyes, municione të ndryshme, granatahedhëse dore, armë automatike, sasi e konsiderueshme e municionit, shok-bomba, uniforma dhe çanta ushtarake. "Të gjitha këto mjete kishin për qëllim dhe shërbejnë për realizim të sulmeve terroriste ndaj qytetarëve dhe institucioneve të Republikës së Kosovës", ka thënë Sveçla në "Facebook". Sipas tij, Policia e Kosovës bashkë me të gjitha organet e tjera të sigurisë vazhdojnë angazhimet e tyre për parandalimin e çdo akti të mundshëm që synon cenimin e sigurisë së Kosovës.

Siç ka theksuar ai, institucionet e sigurisë së Kosovës kanë dhënë informacione se në javët e fundit janë futur nga Serbia në Kosovë vetura dhe automjete të tjera me armatime ushtarake.

Javët e fundit tensionet në veri të Kosovës janë shtuar. Ato nisën më 26 maj, kur kryetari

shqiptar i Leposaviqit, i Zubin Potokut dhe i Zveçanit hynë në ndërtesat komunale me asistimin e policisë.

Që atëherë serbët vazhdimisht kanë protestuar. Protestat u përshkallëzuan në dhunë më 29 maj në Zveçan, kur protestuesit serbë u përleshën me ushtarët e KFOR-it. Nga përleshjet, dhjetëra persona u lënduan nga të dyja palët.

Tensionet u përkeqësuan edhe më shumë më 14 qershor, kur forcat serbe arrestuan tre policë të Kosovës. Serbia thotë se arrestimi u krye "thellë" brenda territorit të saj, por Kosova thotë se ata u rrëmbyen brenda territorit të Kosovës.

Kosova dhe faktori ndërkombëtar kanë kërkuar lirinë e menjëhershëm dhe pa kushte të tre policëve.

Për ta qetësuar situatën në veri, përfaqësuesi i lartë i BE-së për siguri dhe politikë të jashtme, Josep Borrell, ftoi në takim më 22 qershor kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, dhe presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq. Ata u tha se janë pajtuar për mbajtjen e zgjedhjeve të reja.

Borrelli ka thënë se, "pavarësisht prej takimeve të mbajtura" në Bruksel me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti dhe presidentin e Serbisë, Alleksandar Vuçiq, "përshkallëzimi vazhdon dhe po bëhet i rrezikshëm" në veri të Kosovës. Ai ka shtuar se BE-ja nuk do ta tolerojë këtë.



Për shkaqe sigurie, manifestimi i "Vidovdanit" nuk do të mbahet në Gazimestan

PRISHTINË, 25 QERSHOR - Manastiri i Deçanit përmes një njoftimi ka bërë me dije se për shkak të situatës aktuale të sigurisë, ceremonia tradicionale e "Vidovdanit" (Beteja e Kosovës) nuk do mbahet në lokacionin e zakonshëm - te monumenti në Gazimestan, por në Manastirin e Graçanicës më 28 qershor.

Lidhur me këtë, një njoftim është lëshuar edhe nga Dioqeza e Rashkës dhe Prizrenit, ku përmendet situata e sigurisë si dhe arrestimet e serbëve. "Duke marrë parasysh situatën jashtëzakonisht të vështirë në Kosovë, ku populli ynë aktualisht po jeton në një gjendje të pasigurisë dhe ndien mungesë të drejtave

dhe lirive elementare, veçanërisht pas serisë së fundit të arrestimeve dhe keqpërdorimeve të serbëve të paraburgosur, si peshkop dioqezan, me përgjegjësi të plotë baritore, kam marrë vendimin e mëposhtëm: që 'Vidovdani' këtë vit të mbahet në Manastirin e Graçanicës", thuhet në njoftim.



Kompanitë humbin dhjetëra mijëra euro nga bllokada në kufi



PRISHTINË, 25 QERSHOR - Besart Krasniqi tash e një javë i ka të bllokuar 12 kamionë me grurë në kufijtë e Kosovës me Serbinë, përkatësisht në vendkalimet Merdar dhe Jarinjë.

Qeveria e Kosovës ka marrë vendim për ndalimin e kamionëve me mallra dhe targa serbe qysh më 15 qershor, në përgjigje të arrestimit të tre policëve të Kosovës nga forcat serbe më 14 qershor.

Që nga ajo ditë dhjetëra kamionë mbeten të bllokuar në anën serbe të kufijve.

Krasniqi, pronar i kompanisë për përpunimin e produkteve të drithërave "Amidoni Group", me seli në Lipjan, thotë se kamionët e tij janë të ngarkuar me mall nga Serbia, Hungaria dhe Kroacia, por se të gjithë transportuesit kanë targa serbe.

Vlera e përgjithshme e grurit të bllokuar, sipas tij, arrin në rreth 96

000 euro. "Malli nuk mund të kthehet, sepse e ka kaluar Doganën e Serbisë dhe nuk mund ta kthejmë as në Hungari as në Kroaci", thotë Krasniqi për Radion Evropa e Lirë. "Ata [zyrtarët serbë] nuk po i lejojnë [shoferët] të kthehen andej, këta tanët nuk po i lejojnë të hyjnë [në Kosovë]. Kështu që kemi mbetur duke prit", shton ai.

Zyrtarë të Doganës së Kosovës konfirmuan për Radion Evropa e Lirë se asnjë kamion me mallra ose targa serbe nuk ka hyrë në territorin e Kosovës që nga vendosja e ndalesës.

Qeveria e Kosovës e cilësoi ndalesën si masë të sigurisë dhe jo ekonomike apo tregtare. Ajo nuk specifikoi se për sa kohë do të mbetet në fuqi.

Shpejtim Kuqi, pronar i kompanisë për prodhimin e këpucëve "Solid" në Suharekë, ka katër kamionë me lëndë të parë të

bllokuar në kufi. "Asnjëri kamion nuk ka vlerë nën 80 mijë euro", thotë ai për Radion Evropa e Lirë. Kuqi tregon se lëndën e parë e ka të siguruar nga Portugalia, por thotë se transportuesit janë me targa serbe, meqë "kanë kosto më të lirë". Ai shprehet i shqetësuar se mospranimi me kohë i lëndës së parë e vonon produktin final për kompanitë e kontraktuara. "Produktin final, në bazë të kontratës, duhet ta dërgoj në fund të muajit korrik në Itali. Unë me kohë jam mbrapa. Sipas planit, ky material është dashur të jetë në prodhim më 19 qershor. Nëse vonohet porosia, penalizohemi nga kompania blerëse", thotë Kuqi.

Në bazë të një llogaritjeje të Aleancës Kosovare të Biznesit, vlera e mallrave që bizneset e Kosovës kanë të kontraktuara me kompanitë serbe apo të bllokuara në kufi arrin vlerën e 30 milionë

eurove.

Duke folur në një konferencë për medie më 21 qershor, kryetari i kësaj aleance, Agim Shahini, tha se bizneset janë të obliguara të paguajnë interes për transportuesit e bllokuar në kufi.

Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Lulzim Rafuna, thotë se qeveria është dashur të konsultohet me bizneset, apo t'i paralajmëroj ato për ndalesën e mallrave nga Serbia, apo me transportues serbë. "Në pamundësi për të hyrë në vendin tonë, [bizneseve] po u shkaktohen shumë shpenzime për shkak të transportit ndërkombëtar që kanë të kontraktuar për të importuar prej Serbisë, ose për shkak të pagesave që i kanë bërë në kompanitë serbe", thotë Rafuna për Radion Evropa e Lirë.

Në shenjë kundërshtimi ndaj ndalesës së ndërmarrë nga Prishtina zyrtare, shoferë

kamionësh në territorin e Serbisë bllokuan të martën rrugët drejt tri pikave kufitare me Kosovën - Merdar, Jarinjë dhe Bërnjak - duke mos lejuar kamionë me targa të Kosovës të kalonin nëpër territorin serb.

Serbia është ndër vendet me praninë më të madhe të produkteve qoftë ushqimore apo edhe të tjera në Kosovë. Brenda një dite ky shtet eksporton mallra në Kosovë në vlerë prej një milion eurosh.

Në pesë vjetët e fundit, vlera e produkteve të eksportuara nga Serbia në Kosovë ka qenë mbi 1.3 miliard euro, ndërsa prodhimet e Kosovës në tregun e Serbisë kanë arritur vlerën e 215 milionë eurove. Ekspertë të çështjeve ekonomike kanë paralajmëruar se nëse situata në kufi nuk ndryshon për kohë të gjatë, çmimet e disa produkteve në tregun e Kosovës mund të rriten.

Berjani: Çmimet e karburanteve pritet të ulen këtë javë



PRISHTINË, 25 QERSHOR - Kryetari i Shoqatës së Naftëtarëve të Kosovës, Fadil Berjani, ka thënë se çmimi i naftës është 1.24 euro, kurse i benzinës 1.31 euro. Berjani ka thënë se këtë javë pritet të ketë

rënie të çmimeve, sikur që ka ndodhur në tregjet ndërkombëtare. "Është duke reflektuar edhe te ne në 24 orë. Por kur shkruan një gazetë e huaj se ka rënë, çmimi nuk ulet

nëpërmjet shtypit", është shprehur Berjani në Klan Kosova FM.

Ai ka folur edhe për një kërkesë që do ta bëjnë në qeveri për standarde sa i përket ndërtimit të

pikave të furnizimit. "Nuk jemi kundër ndërtimit, por të ketë kriterë sikur në BE jo të ndërtohen pikat e derivateve sikur kërpudhat pas shiut. Në Kosovë më së shumti ka pika karburanti dhe

pushime 15 euro", tha ai.

Në fund Berjani shprehet i habitur me naftëtarët të cilët ankohen për marzhën e fitimit, të në njëjtën kohë po ndërtojnë pika karburanti.

“Kur lëshon qentë e luftës, ata kthehen të të kafshojnë”. Putin më në fund mori mësimin që marrin të gjithë tiranët

Nga Max BOOT*

Presidenti rus Vladimir Putin po mëson atë që shumë tiranë të tjerë mësuhan para tij: Kur lëshon qentë e luftës, ata kthehen mbrapsht të të kafshojnë. Kur i forti i Rusisë dërgoi trupat e tij në Kiev, nuk kishte menduar kurrë se 16 muaj më vonë, mercenarët e Wagner do të marshonin në Moskë.

Por as Napoleoni nuk e imagjinoi se pushtimi i Rusisë do ta çonte atë në azil dhe do të ristrukturonte të gjithë monarkinë franceze. Hitleri nuk e mendoi kurrë se pushtimi i Polonisë do të sillte vetëvrasjen e tij dhe ndarjen e Gjermanisë. Saddam Hussein, po ashtu kurrë nuk mendoi se pushtimi i Kuvajtit do të sillte mposhtjen e regjimit të tij dhe më pas vdekjen. Lufta është një biznes i paqëndrueshëm dhe i rrezikshëm, pasojat e të cilës kurrë nuk shihen me qartësi dhe kurrë nuk gëzohen me sukses. Iluzioni i kontrollit të një diktatori zakonisht shembet në fushëbetje, sidomos nëse bëhet fjalë për një luftë që zgjat, si ajo në Ukrainë.

Shumë analistë kanë supozuar se koha ishte në anën e Putinit në këtë luftë, sepse Rusia është shumë më e madhe se Ukraina dhe sepse Ukraina është kaq e varur nga mbështetja e jashtme nga vendet që mund t'u mungojë durimi për të qëndruar në kurs. Por ne tani po shohim se koha mund të jetë në anën e Ukrainës në fund të fundit, sepse qeveria e saj u zgjodh në mënyrë demokratike dhe gëzon mbështetjen pothuajse unanime të popullit të saj për të zhvilluar një luftë për mbrojtjen territoriale. Regjimi kriminal i pazgjedhur i Putinit, nga ana tjetër, e frikëson popullin rus që të pranojë, por nuk urdhëron besnikëri apo dashuri.

Ashtu si shumë diktatura, regjimi i Putinit rezultoi të jetë më i brishtë se sa duket nga jashtë. Ai është mbështetur gjithmonë në

aftësinë e tij në menaxhimin e qendrave konkurruese të pushtetit, duke vënë kundër njëri-tjetrit oligarkët (dhe degët e ndryshme të qeverisë), në mënyrë që ai të ishte arbitri i fundit i vendimmarrjes. Ky model funksionoi për dy dekada, por po priset mes presionit të një lufte të humbur që po shkatërron dhe shkatërron ushtrinë ruse.

Në shkurt, inteligjenca amerikane vlerësoi se Rusia kishte pësuar të paktën 35,000 ushtarë të vrarë në aksion dhe të paktën 154,000 të plagosur, ndërsa faqja e inteligjencës me burim të hapur Oryx vlerëson se Rusia ka humbur më shumë se 2,000 tanke dhe gati 900 automjete të blinduara luftarake. Rusia nuk ka parë të tilla humbje që nga Lufta e Dytë Botërore. Shkarkimi i shpejtë i trupave ruse – dhe paaftësia e tyre e dukshme – e detyruan Putinin të mbështetej më shumë në Wagner Group, kompaninë private ushtarake të krijuar nga Yevgeniy Prigozhin. Një kriminel që kaloi kohë në burg në Bashkimin Sovjetik në vitet 1980 për grabitje të armatosur dhe vepra të tjera, Prigozhin hapi një stendë hot dog pasi doli dhe e futi atë në një biznes të suksesshëm kateringut që ofronte ushqim për ushtrinë ruse. Kjo çoi në një pseudonim që ai e urren: “Kuzhinieri i Putinit”. Shpejt, ai po gatonte shumë telashe: Agjencia e tij e Kërkimeve në Internet u bë një mjet i dezinformimit rus, duke ndihmuar në sulmin e zgjedhjeve të vitit 2016 në SHBA dhe Grupi i tij Wagner u bë një mjet për Putinin për të projektuar pushtetin në Afrikë dhe Lindjen e Mesme.

Kur Putini vendosi në vitin 2014 të pushtonte Krimenë dhe të nxiste një kryengritje në Ukrainën lindore, Wagner – plot me ish operativë të forcave speciale nga ushtria ruse – ishte një nga instrumentet që ai përdori. Wagner nuk ishte fillimisht në ballë të pushtimit rus të Ukrainës



Mercenarët e Wagner i drejtojnë tanket Shtabit Qendror të Luftës në Rostov

në vitin 2022, por dështimet e ushtrisë ruse i dhanë Prigozhin një hapje për të rrëmbyer në thelb pjesën e tregut nga Ministria Ruse e Mbrojtjes. Shefi i Putinit përgatiti një skemë veçanërisht të pamëshirshme dhe të guximshme duke rekrutuar të dënuar nga burgjet ruse për t'i përdorur në sulmet e valëve njerëzore. Për t'i mbajtur kriminelët në radhë, ai shpërndau një film të një dezertori të supozuar duke u ekzekutuar me goditje në kokë.

Sulmet e Wagnerit në qytetin ukrainas të Bakhmut u bënë fokusi kryesor i ofensivës së ngecur dimërore të Rusisë. Përfundimisht, njerëzit e Prigozhin morën qytetin, por vetëm me një kosto marramendëse: inteligjenca amerikane vlerësoi se, vetëm midis dhjetorit dhe majit, më shumë se 20,000 trupa ruse u vranë dhe 80,000 u plagosën, kryesisht në Bakhmut.

Ndërsa Prigozhin u bë më i fuqishëm, ajo fuqi dukej se i shkante në kokë dhe ai filloi të publikonte video në të cilat talte ministrin rus të Mbrojtjes Sergei Shoigu dhe gjeneralin Valery

Gerasimov, shefin e shtabit të përgjithshëm, si frikacakë dhe kriminelë. Ai i akuzoi ata se nuk siguruan predha të mjaftueshme artilerie për forcat e tij, duke injoruar faktin se ushtria ruse ka rezerva të kufizuara dhe kuptohet se u jep përparësi forcave të veta. “Për shkak të tekave të tyre, pesë herë më shumë djem se sa ishte menduar të vdisnin, kanë vdekur,” tha Prigozhin në një video të filmuar më 20 maj në Bakhmut. “Ata do të mbajnë përgjegjësi për veprimet e tyre, të cilat në rusisht quhen krime”.

Putini nuk dukej se e kishte shumë mendjen; ai ndoshta imagjinonte se një garë për të bërë përparim ushtarak në Ukrainë do të funksiononte në dobi të tij. Por ditët e fundit, rivaliteti midis Wagner dhe Ministrisë së Mbrojtjes doli jashtë kontrollit. Në fillim të këtij muaji, forcat e Prigozhin kapën një oficer rus që ai e akuzoi publikisht se kishte qëlluar mbi një kolonë Wagner. Të premtën, Prigozhin akuzoi ushtrinë ruse për sulmimin e një kampi Wagner, duke rezultuar në shumë viktima dhe, duke iu referuar Shoigut, tha: “Ky lull do të ndalet!” Shërbimi Federal i Sigurisë i Rusisë u përgjigj të premtën vonë duke lëshuar një urdhër për arrestimin e Prigozhin për “nxitje të rebelimit të armatosur”.

Prigozhin nuk priti të arresatohej. Ashtu si Jul Cezari që kaloi Rubikonin, njerëzit e tij marshuan në Rostov-on-Don të shtunën dhe pushtuan selinë ushtarake ruse atje pa luftë. Më vonë gjatë ditës, një kolonë Wagner u nis për në Moskë mes raporteve për barrikadimin e rrugëve drejt kryeqytetit.

“Gjatë orëve në vijim, besnikëria e forcave ruse të sigurisë, dhe veçanërisht e Gardës Kombëtare Ruse, do të jetë çelësi për mënyrën se si do të zhvillohet kriza”, theksoi Ministria Britanike e Mbrojtjes. “Kjo përfaqëson

sfidën më të rëndësishme për shtetin rus në kohët e fundit.”

Duke u përballur me këtë kërcënim të papritur, Putin shkoi aq larg sa thirri Revolucionin Rus të vitit 1917, kur, tha ai, “intrigat, grindjet dhe politikat pas shpinës së ushtrisë dhe popullit rezultuan në një tronditje të madhe, në shkatërrimin e ushtrisë dhe rënia e shtetit.” Natyrisht, ai po e krahasonte veten në mënyrë implicite me Carin Nikolla II, i cili mori vendimin fatkeq për të marrë pjesë në Luftën e Parë Botërore dhe që shkaktoi një rebelim ushtarak me dështimet e tij në fushën e betejës.

Të shtunën në mbrëmje, pas ndërjetësimit të Presidentit Alexander Lukashenko të Bjellorusisë, Prigozhin anuloi përparimin e tij rreth 120 milje larg Moskës, kështu që duket se Putini mund t'i mbijetojë kësaj krize. Si pjesë e kësaj marrëveshjeje, akuzat penale ndaj Prigozhin do të hiqen dhe ai do të shkojë në Bjellorusi. Anëtarët e Grupit Wagner që nuk morën pjesë në revoltë do të nënshkruajnë kontrata me Ministrinë e Mbrojtjes Ruse, por fati i kompanisë mbetet i paqartë. Megjithatë, kriza e Wagner ka zbuluar paqëndrueshmërinë e fshehur të regjimit të Putinit dhe ka tronditur atmosferën e tij të pushtetit. Mund të krijohet ende mundësi për një kundërofensivë ukrainase që, deri më tani, ka qenë vetëm në zhvillim e sipër. Nëse rusët shpërqendrohen nga luftimet e brendshme, Ukraina mund të ketë mundësinë të shënojë më shumë suksese në fushën e betejës – dhe kjo nga ana tjetër mund të minojë më tej pushtetin e Putinit.

Këtu ka një mësim për të gjithë tiranët e ardhshëm që mund të mendojnë të nisin luftëra agresive. A po i kushton vëmendje, Xi Jinping?

*Historian | Burimi: Washington Post



“Shkolla e dështimit”, që ju mëson t’ia filloni nga e para pas gabimeve tuaja



Nga Micol MACCARIO

Nuk ekziston një përkufizim unik mbi “dështimin”. Secili e përjeton atë ndryshe, dhe i jep një kuptim individual. Për shembull, për disa, dështim do të thotë ngelja në një provim apo humbja e vendit të punës. Për të tjerët fundi i një marrëdhënieje në çift apo falimentimi i një kompanie.

E vetmja gjë e sigurt, është se herët a vonë ne të gjithë dështojmë në një mënyrë apo tjetrën. Dështimi ka shumë fytyra. Ka nga ata që e lartësojnë, duke e cilësuar si një hap themelor dhe thujtë të dëshirueshëm për rritjen personale.

Në këtë rast flitet për “failozofinë”, pra artin e të dështuarit me sukses, ose filozofinë japoneze të jetës “shippai”, që tregon një “dështim pozitiv ose konstruktiv”. Por ka të tjerët që e konsiderojnë dështimin si diçka të papranueshme dhe të turpshme, pra si diçka që duhet fshehur.

Qasja e Francesca Corrado, themeluese e Shkollës së Dështimit, është e ndërmjetme. Ajo thotë se dështimi është “pika përfundimtare në një seri

gabimesh shpeshherë sistematike, të cilat nuk janë korrigjuar”. Objektivi i shkollës që ka ngritur, është të mësojë njerëzit të pranojë zhgënjimin që mund të burojë nga një gabim, dhe të përpiqen të shohin të gjithë projektin dhe jo vetëm një rezultat.

Ndonjëherë të kesh gabuar do të thotë të ndryshosh drejtimin, dhe t’i shohësh gjërat nga një këndvështrim tjetër, jo domosdoshmërisht negativ. “Falë gabimeve të mia unë themelova këtë shkollë. Përpara se të isha studiuese në Universitetin e Modenës, merresha me mirëqenien dhe mundësitë e barabarta dhe kisha ngritur një start-up trajnimi dhe konsulence. Në një moment dështova. Humba para, marrëdhënie dhe role. Por jo aftësitë e mia, të cilat më lejuan të rifilloja nga e para”- thotë Corrado. Kështu lindi vendimi për hapjen e Shkollës së Dështimit, me kurse të përkushtuara enkas për shkolla, profesionistë dhe kompani.

“Ajo është një shkollë mendimi. Ne kalojmë kohë duke studiuar dhe arsyetuar se si t’i ndihmojmë njerëzit të kenë një këndvështrim tjetër për atë që u ka ndodhur. Ne duam ta vëmë theksin tek rëndësia e të bërit

gabime të mira. Në fakt, kur gabon nuk mëson asgjë, nëse nuk ndalesh të analizosh gabimet e tua”- shton ajo.

Hapi themelor qëndron tek të kuptuarit e gabimeve. “Është e rëndësishme të kuptojmë procesin nëpër të cilin kaluam dhe që na çoi tek një zgjedhje e caktuar që rezultoi të ishte e gabuar. Dhe më pas të mos e bëjmë më kurrë atë në të ardhmen”- thotë Corrado. Analizimi i gabimeve ju jep mundësinë t’i kuptoni ato, t’i zh dramatizoni dhe ta ndani atë përvojë me të tjerët. Kjo qasje nuk do t’ju pengojë të bëni gabime të reja, por do t’ju lejojë të bëni gabime më të mira. Duke dështuar, keni mundësi të njihni më mirë veten dhe aftësitë tuaja, duke ditur se si të menaxhoni ëndrrat të cilat me kalimin e kohës dhe falë edhe gabimeve, mund të ndryshojnë. Në këtë shkollë mësohet se fundi dhe fillimi shpesh mund të përkojnë. Dështimi mund t’i japë fund diçkaje që nuk ishte më e drejtë dhe të shënojë fillimin e një gjëje më të mirë. Ai mund të jetë një rrugë alternative, e cila nuk do të ishte vlerësuar kurrë në rrethana të tjera.


“Teoria na thotë që të përqendrohemi tek pikat tona

më të forta. Por unë them se vetëm duke kuptuar se çfarë janë ato, ne mund t’ia nisim nga e para me një ndërgjegjësim të ri”- thotë Corrado. Marrja në konsideratë e gabimit, varet edhe nga gjinia dhe mosha. “Gratë kanë më shumë frikë të bëjnë gabime, dhe priren të mendojnë shumë, sepse janë më të mësuara me përsosmërinë. Kjo nuk është çështje biologjike, por varet nga edukimi. Adoleshentët kanë një tendencë për të vepruar më emocionalisht dhe e shohin çdo humbje të vogël si një tragjedi. Fëmijët i përjetojnë ndryshe gabimet, dhe po ndryshe i pranojnë dhe i kuptojnë. Më pas ata hyjnë në një kontekst social në të cilin i rrituri u thotë: “Tani je i rritur mos bëj gabime dhe perceptimi i tyre ndryshon”- thotë Corrado. Shpeshherë pesha e pritshmërive vetjake por edhe e tjerëve bëhet shumë e rëndë, dhe shpesh harrojmë se jeta nuk është një garë, as një sfidë e vazhdueshme. Ka histori të njohura dështimesh që ngjallin shpresë – si ajo e shkrimtares britanike JK Rowling apo Albert Einstein – por ka edhe episode të njerëzve që, të përballur me dështimin, nuk janë në gjendje t’ia fillojnë nga e para.

E sigurt është se qëndrueshmëria dhe kokëfortësia, janë cilësi thelbësore për të arritur synimet, dhe nëse dështimi përballohet në mënyrë pozitive, tek individit zhvillohet këmbëngulja dhe vetëkontrolli. Megjithatë, është e vërtetë që këto aftësi nuk mjaftojnë për të shkruar një libër të suksesshëm apo për t’u bërë një nga fizikantët më të njohur në botë. Njëherazi, të dish se si të pranosh të jesh njeri dhe të nisësh nga gabimet, do të thotë të jesh në gjendje t’i shndërrosh gabimet në kënaqësitë e së ardhmes.

E vërteta është se të dështosh është si të shkosh në shkollë, të biesh në dashuri, të mësosh të ngasësh makinën. Ai është pjesë e jetës, një hap i detyrueshëm, që të gjithë e përjetojnë. Ndaj është mirë të mësosh ta përballosh atë në mënyrën më të mirë të mundshme.

Parë nga këndvështrimi i përmirësimit personal, nuk duhet të ndikojë negativisht as tek vetëvlerësimi, dhe as tek dëshirat e ardhshme. Përkundrazi, në disa raste mund të jetë madje një bekim, sepse ofron mundësinë për të hyrë në shtigje të reja. / “Linkiesta” – Bota.al



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Nuredin Rexhepi, talenti i radhës që i thotë 'po' Kosovës



PRISHTINË, 25 QERSHOR - Një tjetër talent shqiptar që jeton e vepron në Gjermani i thotë "Po" Përfaqësues së Kosovës. Është ky 17-vjeçari Nuredin Rexhepi, qendërmbrojtës i skuadrës VfB Stuttgart. Ai deri më tash ka qenë pjesë e Kombëtares së Gjermanisë U17. Prezantimin e tij e ka bërë kryetari i FFK-së, Agim Ademi, i cili ndodhet për vizitë zyrtare në Gjermani. "Dua të ndaj me të gjithë ju një tjetër lajm të mrekullueshëm pasi talenti i ri, Nuredin Rexhepi, tashmë do të përfaqësojë Kombëtaren e Kosovës.

Nuredini është një 17-vjeçar shumë premtues, qendërmbrojtës i ekipit të VfB Stuttgart. Nuredini, i cili deri tash ka qenë pjesë e Kombëtares U17 të Gjermanisë, ka vendosur të luajë me gjithë zemër për Kosovën. Ky vendim i vlefshëm është marrë nga Nuredini dhe familja e tij, duke shprehur dëshirën e tyre të flaktë për ta përfaqësuar vendin e tyre", ka thënë Ademi. Nuredin Rexhepi ka statistika të shkëlqyeshme në Bundesliga U17, ku ka realizuar 16 paraqitje me skuadrën e VfB Stuttgart dhe

në 92 përqind të ndeshjeve ka luajtur si titullar, teksa është treguar mjaft efikas edhe para portave kundërshtare, duke shënuar katër gola. Kryetari Ademi i ka shprehur mirënjohje bashkatdhetarëve tanë në diasporë, të cilët vazhdojnë t'i rrisin fëmijët e tyre në frymën e atdhedashurisë. Tani mbetet që Nuredin Rexhepi t'i nënshtrohet procedurave të zakonshme dhe të pajiset me shtetësinë e Kosovës, në mënyrë që të ketë të drejtë për t'u paraqitur në fanellën e "dardane".

SHKURT

Gega ia siguron Shqipërisë medaljen e dytë të artë në Lojërat Evropiane

Luiza Gega e ka fituar medaljen e artë në Lojërat Evropiane "Krakow 2023". Atletja shqiptare e arriti këtë sukses në vrapimin 3000 metra me pengesa. 34-vjeçarja medaljen e artë e siguroi falë rekordit që kishte vendosur prej 9:17.31 minuta në këtë garë. Për Shqipërinë është kjo medalja e dytë e artë në Lojërat Evropiane. Medalje të artë fitoi ditë më parë edhe karateisti, Alvin Karaqi.

Berisha, afër marrëveshjes me Prishtinën

Sigal Prishtina është afër kompletimit të skuadrës me basketbollistë vendorë. Kryeqytetasit janë afër gjetjes së gjuhës së përbashkët edhe me kapitenin, Dardan Berisha, sipas burimeve të AsistiOnline.com. Berisha u rikthye në vitin e kaluar te Prishtina, duke e fituar Superkupën e Kosovës, teksa luajti edhe në finale të Kupës dhe në gjysmëfinale të "play-off" -it. Basketbollisti nga Peja ishte i lidhur gjatë ditëve të fundit me një kalim te Peja, që duket se të gjitha mbetën vetëm në kuadrin bisedave dhe Berisha pritet të jetë sërish pjesë e klubit të Prishtinës.

Koulibaly transferohet në Arabi

Kalidou Koulibaly largohet nga Chelsea vetëm pas një sezoni. 32-vjeçari senegalez do të jetë pjesë e Al Hilal në tri vitet e ardhshme. Klubi saudit ka paguar 25 milionë euro në arkat e Chelsea, ndërkohë që Koulibaly do të përfitojë 30 milionë euro në sezon. "Ne dëshirojmë të falënderojmë Koulibalyn për kontributin e tij brenda dhe jashtë fushës gjatë kohës së tij në 'Stamford Bridge'. Dhe t'i urojmë atij suksese në fazën tjetër të karrierës së tij", thuhet në komunikatën zyrtare të "Bluve të Londrës".

Bagnaia i pamëshirshëm në Holandë

Francesco Bagnaia triumfon në Çmimin e madh të Holandës në MotoGP, duke rritur kështu epërsinë e tij në kampionat ndaj ndjekësve. Në këto kushte, piloti italian i Ducatit, Bagnaia ka 35 pikë epërsi ndaj Jorge Martin në pushimin veror, me rinisjen e garave që është programuar për në fillim të gushtit në Çmimin e Madh të Britanisë në Silverstone. "Është fantastike! Nuk ishte e lehtë, ata po shtynin shumë prapa", ka thënë Bagnaia. Në vendin e dytë u pozicionua piloti italian i Ducatit, Marco Bezzecchi. Top-3 u përmbyll nga Aleix Espargaro me Aprilia. Pozita e katërt i takon Binder, sakaq i pesti u pa Martin. MOTO GP sa vjen e bëhet më interesante, më të apasionuarit që mezi presin garat e radhës.

Bajoku renditet i nënti në Lojërat Evropiane

Prishtinë, 25 qershor - Shpëtim Bajoku ka përfunduar garimin në garat e boksit në Lojërat Evropiane Krakow 2023. Boksieri kosovar pësoi humbje nga turku Kagan Bilge Kangli, me rezultat 3:2, kategoria -63.5 kg. Bajoku fitoi raundin e parë,

e humbi të dytën, ndërsa për raundin e tretë, gjyqtarët fitoren ia dhanë boksierit Kagan. "Sidoqoftë, me boksingun e shfaqur sot, por edhe të premtën, Shpëtimi, mbetet shpresa jonë e madhe e boksit dhe sportit të Kosovës, ku

urojmë që ai në turnet kualifikues olimpik, të fitojë normën olimpikë për Paris 2024", thuhet në njoftimin e Komitetit Olimpik të Kosovës. Me një fitore dhe një humbje, Bajoku përfundon në vendin e nëntë.



Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898
Sallon Depilimi Lume's Details
lumesdetails
Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

Gjeje PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjeje Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

facebook www.facebook.com/gjejepuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Armend Juniku nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl.I.II.III.IV dhe diplomën e Gjmnazit "Hajdar Dushi".

- Atnor Nallbani nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjmnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Fitore Xhemajli, shpall te pavlefshme dëftesat e shkollës fillore "Fazli Grajqevci"

- Hysen Berisha nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Teknike "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

- Artiola Batusha nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjmnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Florjan Hajdaraj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl, 10 të SH.M. Ekonomike "Kadri Kusari".

- Nahit Shala nga Rogova e Gjakovës shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Teknike "Nexhmedin Nixha".

- Virxhina Barbullushi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e gjmnazit "Hajdar Dushi" në Gjakovë.

- Muhamet Zherka shpall te pavlefshme diplomën shme " Ymer Prizreni " Prizreni.

- Leon Kuqanaj shpall te pavlefshme dëftesat e shkollës fillore "FAZLI GRAJQEFCI".

- Albana Peci shpall te pavlefshme dëftesën e klasës 10 te shkollës se mesme "Hasan Prishtina".

- "Auto Geti 1" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së.

- Kosovare Imer Hasanaj shpall të pavlefshme Diplomën e Fakultetit të Edukimit në UP "Hasan Prishtina" Prishtinë, Bachelor për shkak të gabimit teknik Kimi –Fizik duhet të jetë Fizik-Kimi me nr. 1243.

- Ilir Sadrijaj nga Gramaçeli, komuna e Deçanit shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11 të sh.m. Ekonomike "Kadri Kusari" Gjakovë.

- Petrit Thaçi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Teknike "Nexhmedin Nixha" instalues i ujit dhe kanalizimit Gjakovë.

- Petrit Thaçi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e SH.M. Teknike "Nexhmedin Nixha" Makinerisë Gjakovë.

- Valon Vala nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjmnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Joni Bajraj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 10 të SH.M.E. "Kadri Kusari" Gjakovë.

- Joni Bajraj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 11 të Gjmnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Irfan Gerbani shpall te pavlefshme 3 dëftesa dhe diplomën Q K "11 Marsi" Prizren.

- Edin Bicaku shpall te pavlefshme 3 dëftesa dhe diplomën QK "11 Marsi" Prizren.

- Visar Ramadani shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IV shfmu "Bajram Curri" Krushë e Madhe.

- CelebicEsef shpall te pavlefshme diplomën QK "11 Marsi" Prizren.

- XhelalFerizi shpall te pavlefshme certifikatën QK "11 Marsi" Prizren.

- Valmir Kadrija shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme "Hivzi Sylejmani" Fushë Kosovë.

- Veton Aliu, shpall te pavlefshme dëftesën e 11 klase te shkollës se mesme "ARKITEKT SINANI".

- Bleona Binaku, shpall te pavlefshme diplomën e shkollës se mesme "FRANG BARDHI".

- Merlind Qorri nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. III të sh.m. Teknike "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

- Remzi Kida nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 11 të Gjmnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Flamur Godeni nga Gajkova shpall të pavlefshme diplomën e Gjmnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Besart Myftari B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb 811937046.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

